



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 22.01.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Mbi shqyrtimin e propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për fillimin e procesit të krijimit të skemës së delegimit dhe transferimit të përkohshëm.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:15 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Medi Bici** (anëtar)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësuese të USAID-it.*

RENDI I DITËS:

1. Mbi shqyrtimin e propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për fillimin e procesit të krijimit të skemës së delegimit dhe transferimit të përkohshëm.

Naureda Llagami: Përshëndetje të gjithëve!

Po fillojmë mbledhjen e datës 22.01.2019.

Prezent janë të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sipas axhendës, pika e parë e mbledhjes është “Mbi shqyrtimin e propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës për fillimin e procesit të krijimit të skemës së delegimit dhe transferimit të përkohshëm”. Dhe pika e dytë e axhendës është “Mbi krijimin e komisionit të përkohshëm për vlerësimin etik dhe profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar”.

Dëshiroj të theksoj që Këshilli, në zbatim të detyrave kushtetuese dhe ligjore, ka detyrim për fillimin e procesit për krijimin e skemës së delegimit, e cila konform nenit 44 të ligjit “Për statusin...” kërkon miratimin e rregullave procedurale të detajuara.

Duke marrë parasysh faktin se krijimi dhe aplikimi i kësaj skeme kërkon një kohë të nevojshme, si dhe fakti që deri tani, pranë Këshillit, janë depozituar 114 kërkesa për delegimin e gjyqtarëve për formimin apo plotësimin e trupave gjyqësore nëpër gjykata, lindi si domosdoshmëri operimi i menjëhershëm për të mundësuar krijimin e kësaj

skeme. Për këtë arsye, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar një projekt-akt si dhe relacionin shpjegues i cili do të trajtohet në këtë mbledhje.

Për më shumë sqarime po ia jap fjalën kryetarit të këtij komisioni, zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, siç jeni njohur të gjithë, nga bisedat, takimet tona informale, është bërë emergjente situata për një numër të konsiderueshëm çështjesh, disa nga të cilat edhe sensitive për publikun, për të cilat Këshilli ka përgjegjësinë kushtetuese që të operojë për të vënë në efikasitet gjykatat për çështje të caktuara. Ndërsa ligji, konsideron dy mekanizma thelbësor për zhbllokimin e kësaj situatë, konsideron një skemë delegimi dhe transferim të përkohshëm. Përgatitëm një projekt-vendim, i cili të konsiderojë apo të vejë në lëvizje procesin për krijimin e skemës së delegimit, e cila është një skemë vullnetare, pra kërkon pëlqimin e magistratëve. Po kështu, konsideruam që po në të njëjtën kohë të konsiderohet menjëherë edhe dhënia e pëlqimit për transferim të përkohshëm, kjo për të fituar kohë për të zgjidhur ngërçin që paraqitet për disa nga çështjet shumë sensitive që na është bërë e ditur nga administrata e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kemi përgatitur një projekt-akt ku konsiderohet një afat i shkurtër për urgjencën që konsideron ky proces. Kemi përgatitur edhe formularët përkatës ku duhet të jepet pëlqimi nga ana e magistratëve, qoftë për kandidim në skemën e delegimit, ashtu edhe për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm. Kemi përcaktuar kryetarin e gjykatës si autoriteti pranë të cilit duhet të jepen/dorëzohen këto kërkesa për kandidim apo për dhënien e pëlqimit, për shkak të kohës së shkurtër, domethënë të fitojmë kohë nëse do të depozitoheshin në një mënyrë tjetër, me postë apo pranë Këshillit), dhe kemi kërkuar nga kryetarët e gjykatës që të operojnë menjëherë për dërgimin e të gjitha kërkesave për delegim për skemën e delegimit apo për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm menjëherë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*Këshillit të Lartë Gjyqësor*), të kuptojmë nëse do të mundet të krijojmë një skemë delegimi vullnetare apo do të kemi një trupë të caktuar gjyqtarësh që janë të gatshëm të transferohen në mënyrë të përkohshme për të operuar për çështjet që janë nevojë imediate përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më tej, kemi konsideruar që në pamundësi të zbatimit të dy mekanizmave të njohura nga ligji, të adaptojmë një mekanizëm të tretë, po të njohur nga ligji, por të përshtatur sipas rrethanave konkrete.

Kjo është një çështje që Këshilli do ta ridiskutojë përsëri, nëse do të lindë nevoja për këtë gjë.

Mundet, për sa i përket dhënies së pëlqimit për transferim të përkohshëm, të kërkohet edhe mendimi i kryetarëve respektiv të gjykatave, por nuk kemi konsideruar ta vëmë si pikë, ta kërkojmë menjëherë në këtë moment mendimin e kryetarëve, qoftë edhe formalisht, pa kuptuar nëse do të ketë vërtetë dhënie pëlqimi nga magjistratët për transferim të përkohshëm. Kemi konsideruar se marrja e pëlqimit të kryetarëve mund të ezaurohet për një periudhë të vogël kohore, qoftë edhe brenda ditës, prandaj nuk e kemi përcaktuar tek projekt-vendimi si një nga veprimet që duhet të ndërmerren në kuadër të procesit të krijimit të skemës së delegimit apo për transferimin e përkohshëm.

Nuk e di nëse duhet të shpjegoj ndonjë gjë tjetër për anëtarët, por kjo është pak a shumë ajo çka kemi përgatitur dhe diskutuar në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: E do njeri tjetër fjalën?

Po, zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Faleminderit!

Atëherë, të gjithë jemi koshient për pjesën e emergjencës që ka situata e krijuar nga çështjet që i janë përcjellë Këshillit për të deleguar/caktuar gjyqtarë për plotësimin e trupave gjykues nga të gjithë gjykatat e vendit, por unë mendoj, ashtu siç edhe kemi diskutuar paraprakisht që së pasi, ligji, me këto dy mundësi që jep për të bërë lëvizjet e gjyqtarëve, pra me skemën e delegimit dhe transferimin e përkohshëm, në përkufizimin që jep në parimet e transferimit, ku përcakton se çfarë quhet ‘transferim’, unë vlerësoj që ky ligj, në mënyrë të qartë, nuk jep mundësinë që ne të caktojmë gjyqtarë për çështje të caktuara.

Skema e delegimit është e mirë përcaktuar tek dispozita se si funksionon, por siç e kemi diskutuar, në disa momente është e paqartë, pra ne besoj, kush e ka të qartë, le ta shprehë, si do funksionojë skema e delegimit që, ne po ju çojmë gjyqtarëve një vendim për të dhënë pëlqimin të përfshihen apo jo, sepse as ligji nuk e ka tërësisht të qartë, as ne

dhe aq më pak gjyqtarët. Ky gjyqtari që do pranojë të jetë tek skema e delegimit, pyetja e parë që ngrihet është: -Do vazhdojë të jetë gjyqtar në gjykatën ku është apo jo?

Në varësi të kësaj përgjigje janë pastaj shumë e shumë diskutime të tjera. Sepse nëse do pranojmë që ai ikën nga gjykata që është, atëherë çfarë do bëhet me çështjet në atë gjykatë, dhe po sikur ky magjistrati të jetë, ky gjyqtari të jetë në ato gjykatat që nuk mund të funksionojnë me largimin e tij? Nga ana tjetër, në qoftë se do të pranojmë që ky gjyqtar do rrijë tek gjykata e vetë, por do jetë edhe tek skema e delegimit, për këtë duhet të kemi një bazë ligjore, sepse dispozita, neni 45 që flet për këtë skemë, në pikën 5 të saj ka një parashikim që të bën të dyshosh se ky gjyqtari do vazhdojë të jetë në gjykatën ku edhe është sepse thotë: *“5. Në pritje për t’u caktuar pranë një gjykate apo prokurorie, sipas parashikimeve të këtij neni, magjistrati në skemën e delegimit shërben në strukturat administrative të Këshillave.”* Që do të thotë, me aq sa e lexojmë ligjin, që ky është i lirshëm, nuk ka lidhje më me gjykatën dhe rri në dispozicion. Tani, pa e qartësuar në këtë gjë, nuk mund t’i kërkojmë gjyqtarëve të japin pëlqimin për një gjë që nuk e dinë se çfarë do jetë.

Tjetra. Nuk jam dakord edhe nga ana e strukturës së vendimit, që njëherësh në t’i kërkojmë edhe dhënien e pëlqimit për skemën e delegimit dhe/ose thuhet në draft vendim ‘edhe transferimi i përkohshëm’. Dua ta them paraprakisht, nuk jam kundër që të fillojnë procedurat/veprimet për t’u krijuar skema e delegimit, por thashë që edhe sikur të ngrihet kjo skemë, e cila jo vetëm do kërkojë, e para njëherë, nuk e dimë a do ngihet dot; e dyta, po u ngrit, do kërkojë kohë; e treta, që është ndoshta më e rëndësishme, nuk na zgjidh problemin e caktimit të një gjyqtari në një çështje të caktuar, që është pikërisht problemi që ne na nxiti për të bërë këtë vendim me emergjencë.

Për ta vazhduar aty ku e nisa, tek përfshirja, tek i njëjti vendim dhe dhënia e pëlqimit, skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm. Unë mendoj që janë dy institute tërësisht të ndryshme dhe janë për situata tërësisht të ndryshme dhe nuk mund të jenë analoge, në mos ke një tërën, ke tjetrën. Sepse transferimi i përkohshëm për mua, në asnjë lloj varianti dhe për shumë arsye, nuk mund të zbatohet për të caktuar një gjyqtar për një çështje të caktuar. Siç edhe kemi bërë diskutime, që në përkufizimin, konceptimin ‘çfarë është transferimi i përkohshëm’, nuk mund të jetë ky mjeti ligjor për të zgjidhur

këtë situatë, sepse e para njëherë, siç fillon dispozita, kjo dispozitë referohesh vetëm kur ti ke skemën e delegimit, që ne nuk e kemi dhe nuk e dimë a do ta kemi, dhe pastaj në këtë skemë delegimi, ty në një moment të caktuar nuk ke magjistratë të disponueshëm për të funksionuar këtë skemë dhe i referohesh pastaj dispozitës 46 për të bërë transferimin e përkohshëm, me dëshirë apo pa dëshirë. Që në këtë moment ne na ndërpritet logjika. Nuk mund të ecim me transferimin e përkohshëm në asnjë lloj rasti.

Pastaj, problemi tjetër që vjen më tutje, siç edhe e kemi diskutuar, paragrafi i dytë i kësaj dispozite e përcakton qartë se si bëhet kur nuk ka pëlqim. Se po të kishte pëlqim, i bie që ne mund të kishim ngritur skemën e delegimit dhe i bie që s'vinim dot tek neni 46, pika 2. Me këtë skemë, siç të gjithë e dimë, i bie që të gjitha dosjet që na kanë ardhur për t'u caktuar trupat gjykues, do na gjykohen nga magjistratët më të rinj në moshë. Por çfarë do të ndodh kur neve kemi problemin dhe shumica e këtyre delegimeve, e këtyre caktimit të trupave gjykues, vijnë nga gjykata e apelit. Tani, këta magjistratët e rinj që ne të gjithë e dimë... janë më shumë sesa, mund të jenë gati gjysma e gjyqtarëve, që janë nën shtatë vjet që plotësojnë dhe formalisht kriterin bazë për t'u caktuar në pozicion për gjyqtar apeli. Si do plotësohet trupi gjykues i apelit, që kemi kërkesat, tek këto 114 kërkesa? Nga cilët do plotësohet? Do shkelim pastaj pikën 2 të nenit 146? Do themi, -ti je gjyqtari me përvojë më të vogël, tek gjykata me ngarkesë më pak. Por ai ka 3 vjet gjyqtar në atë gjykatë. Si do caktohet ai tek apeli, tek çështja që e ke për delegim?

Ndoshta ka edhe arsye të tjera që i kemi diskutuar, por u përpoqa që të them ato që më duken mua më të rëndësishme. Pra unë jam kundër këtij vendimi, për të gjitha ato arsyt. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Ne të gjithë e diskutojmë dhe e pranojmë që sot jemi në një situatë emergjente ku ne duhet të zgjidhim kërkesat për plotësimin e trupave gjykues në rreth 100 gjykata, ndoshta dhe më shumë.

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrën kryesore të administrojë të gjithë sistemin dhe të menaxhojë dhe zgjidhjen e çështjeve. Nuk mund të themi që nuk mund të japim zgjidhje sepse nuk kemi një dispozitë ligjore, mungon ligji. Unë jam e mendimit që nenin 45, që parashikon skemën e delegimit dhe transferimin e përkohshëm, duhet ta

interpretojmë në këtë frymë, që a kemi mundësi që të delegojmë/të caktojmë/të transferojmë (do ta zgjidhim termin e përshtatshëm) një gjyqtar për gjykimin e një çështjeje konkrete. Skema e delegimit është parim i përgjithshëm që vendos ligji, sipas këndvështrimit tim, që gjyqtarët mund t'i caktosh nga kjo skemë delegimi për të gjykuar edhe çështje të veçanta. Unë nuk mendoj që ka pengesë që gjyqtari të vazhdojë të gjykojë çështjen në gjykatën në të cilën ai është i emëruar. Pra skema e delegimit mund të funksionojë si në rastin kur ne mund të kemi një suficiencë të numrit të gjyqtarëve për të bërë një komandim të tyre pranë skemës së delegimit, ashtu edhe në rastin kur ne kemi një mungesë gjyqtarësh të cilët përveç kontributit të tyre që mund të japin në skemë delegimi, vazhdojnë ushtrojnë funksionin e tyre edhe pranë gjykatave të cilët ata janë emëruar.

Në qoftë se ne do të arrijmë të ndërtojmë një skemë delegimi, sigurisht që gjyqtarët, për gjykimin e çështjeve të caktuara, pra jo vetëm për periudha të caktuara, do të caktohen nga kjo skemë delegimi. Transferimi i përkohshëm është një situatë që duhet ta parashikojmë në rastin kur skema e delegimit nuk ka magjistrat të disponueshëm. Dhe në këtë situatë jemi aktualisht. Pra ne po fillojmë procedurat për ta ndërtuar këtë skemë delegimi dhe për të zgjidhur urgjencën po iu kërkojmë njëkohësisht të gjithë gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë që të japin pëlqimin e tyre, për transferim të përkohshëm në rast se nuk do të arrijmë të zbatojmë dot këtë skemë delegimi. Nuk paragjykon në mendimin tim fillimi bashkërisht ose paralelisht i të dy procedurave.

Lidhur me nenin 46, është e vërtetë që transferimi në efekt të ligjit nënkupton caktimin nga një pozicion në një pozicion tjetër, por në qoftë se do t'i lexojmë të gjitha pikat e nenit 46, ligji parashikon edhe mundësinë që për çështje të caktuara edhe pse e parashikon për prokurën e posaçme (*Prokurorinë e Posaçme*) në fakt, mund të komandohen edhe magjistratë të caktuar. Pra transferimi i përkohshëm, për vet faktin që është i lidhur me një afat kohor, duhet parë i lidhur edhe më një çështje të caktuar.

Për këto arsye, mbështes propozimin e Komisionit të Karrierës. Në vlerësimin tim, mund të ishte shtuar edhe pëlqimi i kryetarit për të mos patur vonesa të procedurës së lëvizjes paralele, por për të mos paragjykuar çështjen, le t'i merret ky mendim kryetarëve në një moment të mëvonshëm.

Naureda Llagami: Zoti Toro, të lutem!

Alban Toro: Do më duhet pak të sqaroj produktin që ka prodhuar ky komision, për faktin që po i përgjigjemi një emergjence. “A mali estemi estemi rimedi”, është një parim i njohur dhe jemi të detyruar që brenda mekanizmave që ka ky ligj, të mundësojmë një mekanizëm i cili do të na mbushë boshllëqet që na janë krijuar. Pra, unë për vete jam koshient (nuk besoj se tek të tjerët ka ndonjë ndryshim), që ne po mundohemi të mbajmë në këmbë një sistem.

Në rastin konkret, ligji ka parashikuar një sistem të shëndetshëm dhe ka vlerësuar si prioritet vullnetin e personave të cilët normalisht duhet të ishin në një listë pritje, për të shërbyer atje ku ka nevojë atdheu (e folur në kuptimin figurativ). Unë jam koshient që kjo listë nuk do bëhet ndonjëherë por do na duhet patjetër që ne të krijojmë një mekanizëm i cili do mbushë boshllëqet që ka aktualisht jo vetëm ligji me mos parashikimet e tij, por edhe vetë sistemi që kërkon dhe ka uri për individë të cilët duhet të jenë patjetër në një pozicion të caktuar për t’iu përgjigjur emergjencës. Në këtë kontekst kemi ideuar që të përfitojmë nga dispozita e nenit 46, duke përfitur nga kriteret që ka transferimi apo parimet që ka kjo dispozitë, pra lëvizje e përkohshme nga një pozicion i caktuar në një pozicion tjetër, e cila nënkupton edhe çështje të caktuara, dhe të detyrojmë individin që në rast të mos dhënies së – kjo është e sigurt që nuk do japi askush pëlqimin – në rast mos dhënies së pëlqimit, ta detyrojmë të shkojë përkohësisht për një çështje të caktuar. Kështu që, në këtë kontekst, të jemi të sigurt që ky produkt është e vetmja mundësi që ne kemi t’i përgjigjemi rasteve të emërimeve për çështje të caktuara. Nuk ka asnjë lloj mekanizmi tjetër, të paktën në këtë ligj, sepse ligji është parashikuar për një sistem të shëndetshëm dhe jo sistemin aktual, nuk ka asnjë lloj mekanizmi tjetër që do t’i përgjigjej realitetit aktual që është krijuar në gjyqësor.

Kështu që, i ftoj kolegët ta votojmë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toro!

Kush e do fjalën?

Zoti Medi!

Medi Bici: Neni 45 i ligjit parashikon që pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*Këshillit të Lartë Gjyqësor*) të formohet një bërthamë prej gjyqtarëve, që nuk do të thotë

që do të jenë vetëm nga shkalla e parë, por mund të jenë edhe nga gjykata e apelit, të cilët do të jenë disponibël për të zëvendësuar boshllëqet në gjykatat e tjera. Jam i të njëjtit mendim me zonjën Brunilda se kjo strukturë duhet të jetë permanente dhe të shkëputet nga gjykatat ku gjyqtarët... dhe do të jetë gjithmonë në dispozicion të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Por këtë nen, për mendimin tim, ne do kemi vështirësi për ta zbatuar për shkak të pëlqimit që mund të mos e japin gjyqtarët e gjykatave të shkallëve të para dhe të gjykatave të apelit dhe jemi të detyruar të kalojmë në transferimin e përkohshëm. Kur kalojmë në transferimin e përkohshëm, nuk zbatohet më neni 45. Ne përsëri ua kërkojmë pëlqimin gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apelit, pastaj kalojmë në zbatimin e pikave të tjera të këtij neni.

Kështu që, mendoj që Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e ka kuptuar drejt zbatimin e nenit 46, duke bërë përpjekjet e para. Kjo mund të bëhesh edhe veç e veç në fakt, një herë të zbatonim nenin 45 dhe pastaj, pasi të merrnim pëlqimin e gjyqtarëve, të kalonim tek zbatimi i nenit 46. Por në situatën emergjente që jemi, mendoj që të gjitha pikat që janë ngritur ne projekt-vendim për mua qëndrojnë dhe nuk kam vërejtje të tjera.

Naureda Llagami: Po, zonja Bruna!

Brunilda Kadi: Okej! Atëherë, siç e thashë në fillim, duke mos e shpjeguar, të paktën edhe tek vendimi, një nga arsyet pse gjyqtarët, me logjikë, nuk do pranojnë asnjëri, është se ata nuk e dinë se çfarë do ndodhë me ata sepse vendimi nuk e sqaron njëherë. Pra do jenë apo s'do jenë tek gjykatat e tyre. Dhe kur nuk e dinë se çfarë do jenë, -unë nuk e di në do ketë gjyqtarë në Republikën e Shqipërisë që të pranojë një gjë që nuk e di se çfarë është, e para. Pra vetëm për këtë arsye do dështojë dhënia e pëlqimit. Vetëm për këtë arsye. Jam shumë dakord - se ndoshta ishte nga ana ime një lloj lapsusi që nuk u shpreha fillimisht - edhe unë kam qenë ndër të parët që kam nxitur këtë diskutim sepse është emergjente dhe ne duhet ta zgjidhim. Nuk mund të rrimë pa e zgjidhur se s'ka ligj. Duke qenë se ato arsyet që thashë më lartë, nuk ka nevojë ti përsëris, them që ne e bëjmë skemën, jo skemën e delegimit, por një situatë tjetër, që ligji nuk na i thotë shprehimisht, por ne mund ta zbatojmë drejtpërdrejt nga Kushtetuta dhe ligji. Pra në vazhdim të asaj që nisi të thoshte në fillim Brikena. Jemi të detyruar, jemi përgjegjës, do zgjidhim situatën,

por jo duke i referuar dy dispozitave shumë specifike që unë mendoj që rregullojnë situata të veçanta që s'kanë lidhje me rastin konkret.

Për sa i përket interpretimit të nenit 46, pika 3, që tha Brikena se, kjo dispozitë ne na lejon për çështje të caktuara, në kundërshtim me interpretimin që bën Brikena, unë them që pikërisht kjo dispozitë nuk na lejon ne, ky parashikim (pika 3) nuk na lejon neve që të bëjmë këtë që duam të bëjmë sepse kur ligji ka dashur të bëjë përjashtimin se çfarë është transferimi i përkohshëm, e thotë pikërisht për çështjet specifike të Prokurorisë, pra është e kundërta e interpretimit... –Okej, ky është mendimi im. ...Dhe që transferimi i përkohshëm do të thotë që ti lë dosjet aty ku je dhe ikën në një gjykatë tjetër, për mua kjo nuk ka pikën e diskutimit sepse është kaq e qartë që në koncept se çfarë është transferimi, që tek neni 42 ku jep përkufizime dhe nga fillimi deri në fund të dispozitës.

Kështu që, për mua, caktimi i gjyqtarit për një çështje të caktuar sipas nenit 46, - po hajde t'ia ndryshojmë emrin nenit 46 e ta quajmë kështu e ta quajmë ashtu, -për mua është shkelje më e rëndë sesa të zbatojmë drejtpërdrejt ligjin dhe Kushtetutën dhe nëse nuk do kemi skemë delegimi, të paktën është më e pranueshme sesa transferimi i përkohshëm, zbatojmë drejtpërdrejt ligjin dhe Kushtetutën dhe të ecim me caktimin e gjyqtarëve me short, duke i konsideruar të gjithë, të futen, në qoftë se do ta quajmë skemë delegimi, duke qenë të barabartë me të gjithë dhe ata me njëri-tjetrin dhe duke respektuar edhe parimin e gjyqtarit natyral sepse përveç problemeve që ka neni 46 “Transferimi i përkohshëm”, neve në qoftë se do zbatojmë këtë, ne paracaktim trupat gjykues dhe në çdo kohë e ke të kundërshtueshëm atë trupin gjykues nga cilido subjekt që do cenohet nga vendimi i atij trupi gjykues.

Brikena Ukperaj: Atëherë, për të vazhduar edhe logjikën e mendimit të mëparshëm. Aktualisht nuk jemi në luksin që secili nga ne të thotë mendimin se si do të delegojmë një gjyqtar nga një gjykatë dhe ta çojmë në një gjykatë tjetër. Gjithashtu vlerësoj që ne nuk mund të ndërtojmë dot dispozitë ligjore për të parashikuar një mënyrë të ndryshme të delegimit vetëm atë çka parashikuar ligji. Ligji ka thënë që ke skemë delegimi dhe 46/1 thotë: “Në rastin kur në skemë delegimi nuk ka magjistratë të disponueshëm...”, pra i ka të dyja situatat. Skema e delegimit është kjo dhe kur s'ke magjistratë të disponueshëm do shkosh tek 46-ta. Unë thashë, jam koshiente për mënyrën

dhe përkufizimin që ligji i jep konceptit të transferimit, por tek transferimi i përkohshëm, caktimi nga një pozicion në një pozicion tjetër ta interpretojmë në frymën e 46/2, 3 dhe 4 që ka të bëjë edhe për çështje të caktuara. Ky ishte mendimi im.

Naureda Llagami: Zoti Toska!

Ilir Toska: Të gjithë jemi dakord që ne duhet të bëjmë diçka që të zgjidhim situatën. E vetmja kundërshti që duket në këtë tavolinë është mënyra se si duhet ta arrijmë atë. Opsioni që paraqet Bruna që ne mbi bazën e përgjegjësive Kushtetuese të krijojmë një mekanizëm të ri që nuk e ka ligji, mjaft që të zhbllokojmë situatën, mbetet opsional, por nuk më duket më i pranueshëm në raport me detyrimin që kemi dhe të respektojmë kuadrin ligjor në fuqi. Në Komisionin e Karrierës konsideruam që të jemi sa më afër ligjit dhe të adaptojmë këto mekanizma që ligji njeh, duke i dhënë atyre një kuptim të caktuar. Sa i përket skemës së delegimit, kemi konsideruar që në skemën e delegimit nuk konsideron ligji, të paktën në interpretimin tonë, që një gjyqtar duhet të lëvizë nga pozicioni i tij i punës. Ne kemi konsideruar që gjyqtari do të vazhdojë të jetë në pozicionin e tij dhe në raste nevojë do të vazhdojë po të njëjtën detyrë në të njëjtin nivel apo në një nivel më të lartë, sipas kritereve që ai përmbush, ku një gjykatë ka nevojë, qoftë edhe për një çështje konkrete.

Mundet që ne këtë interpretim tonin, nëse konsiderohet se, apo shumica jonë ndajmë të njëjtin, ta konsiderojmë ta përfshijmë edhe tek vendimi, mbase që edhe magjistratët të jenë të qartë se kush është opinioni i ligjit nga ana e Këshillit.

Nuk e di të ketë nevojë për diçka, të përdoren në çdo rast termat që ligji konsideron tek ky projekt-vendim, pra që është skemë delegimi dhënie pëlqimi për transferim të përkohshëm. Por nuk mendoj se kemi një mekanizëm tjetër që ne mund të përafrojmë, të zbatojmë ligjin, pavarësisht se ligji flet për një realitet tjetër dhe ne jemi në një realitet që nuk ka lidhje me atë që ligji konsideron se ne do të ishim në luksin të bënim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: E rëndësishme edhe për gjyqtarët, meqenëse u hodh ideja se si duhet kuptuar neni 45, unë shpresoj, uroj dhe besoj që të gjithë gjyqtarët nenin 45 ta kuptojnë të tillë që me shfaqjen e dëshirës për të kandiduar për skemë delegimi,

automatikisht nuk do të thotë që gjyqtari do komandohet nga gjykata dhe do futet në skemën e delegimit. Gjyqtari do vazhdojë aktualisht funksionin e tij si gjyqtar pranë gjykatës që është, plus pjesëmarrjen në skemën e delegimit që ka shumë benefite për gjyqtarin, jo vetëm për sa i përket efektit financiar, por edhe sa i përket vlerësimit etik dhe profesional, çka merret parasysh nga ana e Këshillit.

Naureda Llagami: Atëherë, ta hedhim në votë propozimin nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Keni nevojë për ndryshime?

Të vazhdojmë me propozimin siç e ka propozuar...?

Me mikrofon!

Ilir Toska: E vetmja gjë që ne mund të konsiderojmë – po flas në emrat e Komisionit të Karrierës – është vetëm interpretimin që ne konsiderojmë për nenin 45, pra për skemën e delegimit. Nëse është me vend ta evidentojmë në këtë projekt-vendim apo ta marrim të mirëqenë që interpretimi duhet të jetë ky që ne po themi këtu.

Naureda Llagami: E diskutojmë këtë çështje këtu?

Ilir Toska: Çdo anëtar mund të japë opinionin e tij dhe nëse do jetë e nevojshme le ta votojmë nëse ta përfshijmë këtë interpretim apo jo.

Brikena Ukperaj: Unë mendoj që, aktualisht nuk kemi pengesë që për shkak të situatës të cilës ndodhet sistemi ku ka mungesë gjyqtarësh, tek pika 2 e vendimit të shtojmë: “2. Të kërkohet pëlqimi i të gjithë magjistratëve në gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit në Republikën e Shqipërisë që, pa u larguar nga pozicioni i tyre, të kandidojnë në skemën e delegimit”, ose edhe diçka tjetër, por të shtohet këtu, që pa lënë pozicionin e tyre të kandidojnë për skemën e delegimit, sipas nenit 45. Sepse ky është një vendim që bëjmë në rastin konkret nuk e kemi... që edhe gjyqtarët ta kuptojnë. Sepse ndoshta e lexojnë ligjin dhe thonë që po të kandidoj, do detyrohem që të lë funksionin e të shkoj magjistrat i komanduar pranë Këshillit.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Për hir të qartësisë së dispozitës, edhe unë propozoj shtimin e sqarimit që gjyqtarët të vazhdojnë të ushtrojnë detyrën pranë gjykatave ku janë të emëruar. Kështu

që, me një amendim të pikës 2, bëhet më i qartë i gjithë kuptimi i dispozitës, prandaj jam në favor të amendimit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Tjetër ide, të lutem!

Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Për sa i përket projektit që ka përgatitur Komisioni i Karrierës, unë jam plotësisht dakord, por nuk jam shumë dakord me këtë pjesën e dytë që të shtojmë tek një vendim, të shtojmë një pikë që t'u themi atyre se kështu do të kuptohet ligji. Ne të zbatojmë ligjin dhe ashtu siç thotë, të bëjmë shkresën për fillimin e procesit të krijimit të strukturës të skemës së delegimit. Që do të thotë, ashtu siç e ka parashikuar ligji, që kush nga këto do të paraqesë vullnetin për të marrë pjesë tek kjo. Mund të kemi një relacion shpjegues pastaj sa i përket kësaj, por jo që të jetë e përcaktuar...

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Po pastaj kur të ketë pretendime, do t'i referohet relacionit ai apo vendimit?

Dritan Hallunaj: Ta mbaroj unë njëherë, pastaj...

...dhe them, mendimi im është ky, që të jetë vetëm pjesa e fillimit të procesit të krijimit të skemës së delegimit. Që do të thotë që, gjyqtarët që do të shprehin vullnetin për të marrë pjesë në këtë skemë delegimi, t'i jepet koha e caktuar. Nuk kemi pse paragjykojmë që jo po s'do vijë asnjëri se... Ta shohim. Pastaj hap pas hapi do ndjekim hapat e tjera. Dhe të gjithë lexojmë dhe kuptojmë ligjin. E lexojmë në atë mënyrë që gjyqtari – edhe unë ashtu e shoh – që gjyqtari nuk ka arsye pse të transferohet dhe të iki nga ajo gjykatë në një gjykatë tjetër por gjyqtari duhet të ketë emërimin, se këtë koncept ka edhe transferimi, edhe komandimi që ka qenë dikur edhe delegimi, që gjyqtari vazhdon paguhet në atë gjykatë ku është por ushtron funksionet edhe për llogari të gjykatës tjetër.

Për të tjerat pastaj do t'i shprehë Bruna, ato çfarë kam unë mendim për të thënë. Faleminderit!

Brunilda Kadi: Meqë më përmendi emrin.

Sa i përket pagesës, ka mënyra të tjera të llogaritjes dhe skema e delegimit ka dispozita të veçanta tek ligji, pra nuk është – me sa e di unë – ashtu siç e tha kolegu. Por

nuk mendoj se sqarohet me relacion, se kur të ketë pretendime, nuk do referohet në relacion magistrati ose subjektet e tjera që mund të kenë ankim. Dhe unë mendoj që nëse bëhet ky vendim, patjetër duhet të sqarohet në vendim se çfarë bëhet me vendin dhe do shërbejnë këta gjyqtarë në skemën e delegimit dhe kur do t'i fillojnë nëse do vazhdojnë të jenë në gjykatën e tyre, deri kur? Kur të fillojë që të komandohen për herë të parë tek caktimi? Se ideja është që ata janë të disponueshëm. Nuk do të thotë që direkt, sa të miratohet skema e delegimit, ata u futën. Ata janë thjesht të disponueshëm. Kjo është ideja e skemës së delegimit. Unë mendoj që duhet të sqarohen në qoftë se do miratohet vendimi. Megjithatë ky ishte mendimi im.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi më diskutime lidhur me...?

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, Bruna po flet se si do zbatohet skema e delegimit.

Ne jemi në momentin kur po tentojmë të ngremë skemën e delegimit. Nëse ne do konsiderojmë që do të ketë kandidime, ne do duhet t'i miratojmë ato kandidime që t'i përfshijmë në skemën e delegimit dhe prej atij momenti do konsiderojmë edhe efektet që sjell përfshirja në një skemë delegimi. Nuk mendoj se duhet të jetë pjesë e kësaj vendimmarrjeje që ne po tentojmë të krijojmë skemën e delegimit. I vetmi ngërç është, nëse të gjithë e kuptojnë ligjin si ne të Komisionit të Karrierës e kemi kuptuar, nuk mendoj se duhet ta përfshijmë në këtë draft, në këtë projekt-vendim, pjesën që nuk duhet të lëvizin nga detyra, nëse është e qartë për të gjithë kështu. Nëse kjo është e paqartë, ne jemi të hapur që ta përfshijmë edhe këtë, në kuptimin që, ligji thotë në këtë mënyrë.

Naureda Llagami: Atëherë, unë mendoj që ta hedhim në votim këtë çështje, nëse neve do pranojmë propozimin e sjellë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pa ndryshime në projekt-draft apo do pranojmë propozimin e bërë nga një anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor për shtesën, për amendimin në pikën 2 të projekt-vendimit. Mendimi që ta kalojmë në votim këtë gjë?

Po, zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Desha vetën të ndërhyj duke thënë që, për shkak të diskutimeve që u bënë këtu, del që edhe midis nesh është e paqartë nëse gjyqtarët vazhdojnë të mbeten në gjykatat ku janë nëse do vazhdojnë të marrin pjesën në skemën e

delegimit, dhe gjykoj që edhe gjyqtarët do të kenë po të njëjtin konfuzion në lidhje me këtë. Prandaj edhe pak më parë u shpreha pro propozimit për amendimin e dispozitës. Faleminderit!

Marçela Shehu: Në fakt, kam përshtypjen që i gjithë debati apo skepticizmi lidhur me këtë moment vjen nga pika 5 e nenit 45, ku thuhet që në pritje që ky gjyqtar i parashikuar në skemën e delegimit pret që të caktohet pranë një gjykate, magjistrati shërben në strukturat administrative të Këshillave. Kështu që mendoj që ne duhet t'i bëjmë fillimisht një interpretim kësaj pike sepse duke e lexuar në mënyrë të drejtpërdrejt, kjo dispozitë të lë të kuptosh që ky gjyqtar i përfshirë në skemën e delegimit, nëse nuk ka nevojë që të shkojë diku tjetër, atëherë ky do të shërbejë pranë Këshillit. Pra është pikërisht ky interpretim që do t'i japim kësaj pike apo interpretimi që ky gjyqtar do të shërbejë në strukturat administrative të Këshillave kur nuk ka punë as në gjykatën mëmë (pra ku është i emëruar) dhe as në gjykatat që ka nevojë sistemi. Pra ta sqarojmë këtë momentin dhe më pas, mendoj unë, të kalojmë në votim, që të jemi edhe ne të qartë lidhur me këtë pikë.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Tek neni 45 ka dy dispozita që duket sikur konfundojnë njëra-tjetrën. Pika 1 flet për magjistratët për të gjitha shkallët, që do të thotë, janë në detyrë, ndërsa pika 5 kuptoj që flet për magjistratët e emëruar, por që s'janë në një pozicion të caktuar. Pra e gjithë skema e delegimit nuk përjashton magjistratët që janë në një pozicion të caktuar por konsideron edhe magjistratët që nuk janë caktuar në një pozicion të caktuar por janë të emëruar. Prandaj krijohet konfondimi që kjo skema e delegimit do të përfshijë vetëm magjistratët që nuk janë nëpër pozicione të caktuara, thjesht kanë marrë emërimin dhe ata janë si një trupë lëvizëse, sipas nenit 5, që mund të shërbejnë edhe pranë Këshillit.

Pika 1 e këtij ligji bën fjalë për magjistratët në të gjitha shkallët, të paktën në 1 vit me përvojë, do të thotë që janë në një pozicion pune, duke ushtruar funksionin e magjistratit. Nuk bën fjalë për të tjerë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Zoti Qoku!

Maksim Qoku: Në fakt do qëndroj në logjikën e koleges që foli më parë, Marçela, por edhe t’i japë përgjigje pak Brunës në lidhje me aplikimin e nenit 45, kundrejt nenit 46. Ne po t’i referohemi nenit 42 “Parimet e transferimit”, të paktën krijojmë idenë se si ligji e koncepton transferimin. Unë mendoj që neni 45 është taksativ dhe pika e 1-rë sqaron faktin ose themi konceptin mbi skemën e delegimit sepse thotë: “1. *Magjistratët në të gjitha shkallët mund të kandidojnë – pra flitet për kandidim – për t’u komanduar – pra përdor ligji termin komandim – në skemën e delegimit që krijohet në Këshill*”. Atëherë, unë kuptoj që është një proces i tërë që përfshihen magjistratët që duhet të kandidojnë me vullnetin e tyre por të komandohen në një profesion, ose më falni, në një pozicion, i cili është pranë Këshillit. Kjo më bën që të jem me logjikën e Marçelës që këtu flitet për gjykatës që shkëputen nga vendi i punës, nuk janë më atje.

Ndërkohë, pika 3, më falni, pika 5 e cila vjen pas pikës 1, në formulimin në pritje për t’u caktuar pranë një gjykate, flitet për këto gjyqtarë që janë konsideruar ose janë bërë pjesë e kësaj skeme dhe që në pritje të atij caktimi apo delegimi – pra termi ‘caktim’ dhe ‘delegim’ duhet të kenë kuptim të njëjtë – do marrin përsipër që të angazhohen në punët e Këshillit.

Mirëpo edhe pjesa e dispozitës e cila nënkupton faktin që shërbejnë në strukturat e Këshillit nuk tregon gjë tjetër veçse faktin që ata gjykatës apo magjistratë nuk kanë më lidhje me gjykatën nga të cilat vijnë. Pra skema qëndron e pavarur dhe pasi krijohet në Këshill, funksionon si e tillë, sepse u mundëson që të kandidojnë me vullnetin e tyre, i mundëson Këshillit që të çmojë të gjitha kushtet dhe ta përpilojë këtë skemë dhe pasi ta krijojë, ne jemi përpara një skeme, pavarësisht nëse do ndodhë apo jo. Dhe më pas shoh që, transferimi i përkohshëm, neni 46, pika 1 apo 2, bëhet si një zgjidhje në rastin kur ne nuk kemi shprehje pëlqimi dhe në rastin kur vihemi para një situatë të ngutshme, ku si pasojë e mos krijimit të skemës dhe mos dhënies së pëlqimit, detyrohemi që të bëjmë edhe një transferim pa pëlqim, i cili shkon deri në 1 vit.

Bile unë iu referova, kam parë edhe nenin 53 të komandimit, mënyra si e përcakton ligji pjesën... (pika 1), dhe në fakt komandimi, si një proces që e merr magjistratin nga fusha e tij (sistemi) dhe e çon në një institucion, duke e konsideruar jo magjistrat, me kërkesë të atij institucioni, nuk është gjë tjetër por në fakt një shkëputje e

magjistratit nga ajo (për një periudhë 5 vjet e përcakton aty), por ama ligjvënësi ka përdorur termin ‘kandidojnë për t’u komanduar’, çka do të thotë, në aspektin e kësaj, kjo skemë delegimi qëndron e pavarur dhe bëhet pikësëpari, pa u ndikuar nga transferimi i përkohshëm, transferimi me ose pa vullnet, kjo është ideja. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ah, zoti Medi!

Medi Bici: Maksi e kuptoj komplet idenë që kisha unë. Prandaj thashë, pika 5 e nenit 45 nuk të lë shteg për të interpretuar. Ne duhet të kemi një përthamë nga të gjitha shkallët, se unë e përjashtova Gjykatën e Lartë, se s’ma merr mendja që do kandidojë njeri nga... pra për t’u komanduar më ulët, prandaj thashë nga gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit. Ne duhet të kemi një bërthamë dhe ato janë 5 vjet. Prandaj thashë. Kush ka qenë qëllimi i ligjvënësit që e ka vënë këtë që këto të shpëputen nga gjykata mëmë? Sepse këto nuk do të kenë kohë, do të kenë shumë pak kohë bosh sepse do të jenë gjithmonë të emëruar (në qoftë se pranojnë për 5 vjet). Kjo pjesë e boshllëkut do mbushet me punën që do bëjnë në Këshill. Tani nuk jam në gjendje t’ju them një nen, që ne mund të thërrasim gjyqtarë magjistratë për të na ndihmuar ne edhe pa pagesë. Ne s’e zbatojmë dot se këtë e thashë, ne mund t’i zbatonim të dyja këto procedura të veçuara, një të zbatonim vetëm nenin 45, pra t’u kërkonim gjyqtarëve nëse ato do të na jepnin pëlqimin për të krijuar këtë bërthamë dhe nuk shkonim tek neni 46, ose i kemi bërë të dyja bashkë për të kaluar tek neni 46. Neni 46 tani na thotë që t’u drejtohem të gjithë gjyqtarëve, duke zbatuar njëherë pëlqimin...

Pastaj, jam me të njëjtin mendim me zonjën Lubonja, këto mund të caktohen edhe për çështje të caktuara. Pra një gjyqtar që është në dispozicion të Këshillit, sipas nenit 45 për delegimet, do çohet një herë në Kukës, një herë në Has, një herë ku të kemi gjykata të tjera.

Naureda Llagami: Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Kam përshtypjen që dispozita neni 45 u interpretua nga Zëvendëskryetari sikur magjistratët në skemë delegimi komandohen.

(Zoti Qoku flet pa ndezur mikrofonin.)

Maksim Qoku: Ashtu e përdor ligji. Jo thashë unë.

Ilir Toska: Të lutem!

Nëse e përdor ligji, mund ta citojmë.

Por kam përshtypjen se ligji, neni 45, nuk flet për magjistratë të komanduar, në asnjë moment. Ligji flet për magjistratë në të gjitha shkallët. Ligji flet edhe për magjistratë që mund të funksionojnë pranë Këshillit gjatë kohës që nuk kanë nevojë gjykatat. Kjo nuk do të thotë që nuk janë magjistratë apo janë magjistratë të komanduar dhe që janë komanduar pranë Këshillit. Magjistrat i komanduar është një koncept tjetër që nuk ka lidhje me nenin 45. Ligji nuk konsideron fare që skema e delegimit të përbëhet nga magjistratë të komanduar. Nuk përmend ligji një gjë të tillë.

Maksim Qoku: Në qoftë se ke ligj tjetër, po ta lexoj.

Neni 45: “Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën 1 vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për të komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill.”

Unë nuk thashë ‘komandim’. Unë thashë i jam referuar aspektit të komandimit për të nxjerrë kuptimin në lidhje me interpretimin që duhet të bëjmë neve, nëse qëndron në institucionin e mëparshëm apo i shkëput lidhjet? I ikim komandimit, kthehemi në pikën e parë të nenit dhe thashë mund të kandidojë për t’u komanduar, çka do të thotë, për t’u deleguar. Edhe në pikën 5, ligjvënësi ka thënë ‘caktuar në detyrë’, por deleguar është logjika sepse jemi tek “Magjistratët në skemën e delegimit” – titulli i nenit. Kjo ishte logjika ime.

Ilir Toska: Atëherë, magjistrati i komanduar, në kuptim të ligjit, nuk do të thotë që do vazhdojë të ushtrrojë po funksionin e magjistratit, por do të thotë që shkëputet nga funksioni i magjistratit dhe ushtron një funksion tjetër ku ai bën një kërkesë dhe Këshilli konsideron se mund të veprojë. Nuk mundet që të konsiderojmë të komanduar gjyqtarë që janë në detyrë dhe t’i kërkojmë të vazhdojnë të bëjnë po detyrën e magjistratit.

Naureda Llagami: Atë që unë doja t’i ftoja koleve për diskutim është që, ky projekt-vendim, mesa kemi kuptuar nga i gjithë debati dhe nga përmbajtja e propozuar nga komisioni përkatës, ka të bëjë me një fazë paraprake për krijimin e skemës së delegimit. Pra, unë nuk dua të hamendësoj se si do jetë situata pas marrjes së pëlqimit nga trupa gjyqësore. Le ta shtyjme këtë debat në një situatë tjetër, në situatën paraprake... Me

sa kuptova nga kryetari i komisioni, se si e relatoi vendimin, është që ne të marrim, që në konceptin e projekt-vendimit, është fillimi i procesit të krijimit të skemës së delegimit. Që do të thotë, që neve nuk e kemi krijuar ende. Pra po fillon hapat Këshilli që ta krijojë. Po reagojmë në mënyrë të shpejtë për shkak të situatës emergjente që më është krijuar brenda Këshillit (114 kërkesa). Pra le t'i hapim derën krijimit të skemës; le të pranojmë faktin që për skemën e delegimit do na duhet dhënia e pëlqimit; le të pranojmë faktin që nëse ne na dështon kjo skemë, ligji detyrimisht na çon tek transferimi në kuptim të nenit 46; kështu që për mua ky është thjesht inicimi i një procesi që është shumë emergjent për situatën aktuale.

Atë që unë ju ftoj për diskutim dhe për ta hedhur në votim është se si do jetë projekt-akti, do pranojmë propozimin, të kalojmë propozimin fillimisht të propozuar nga komisioni, ashtu siç është, pa ndryshime dhe më pas hedhim në votim propozimin që bëri zonja Lubonja për pikën 2 të projekt-vendimit? Jeni dakord?

(Disa nga anëtarët mendojnë që duhet të hidhet shtesa përpara në votim.)

Okej! Atëherë,...

Brunilda Kadi: Një sekondë, se e tha Marçela. Përpara se të hedhim në votim këtë, ju thoni që gjyqtarët e lexojnë ligjin vet, ta kuptojnë vet. Ne jemi 11 juristë këtu dhe me sa e pamë nga debati kishim mendime të ndryshme. Hajde ta vendosim ne të gjithë si e kuptojmë ligjin, me shumicë votash, që t'iu bëjmë të qartë atyre gjyqtarëve që po i kërkojmë dhënien e pëlqimit, se për çfarë po e japin pëlqimin. Se s'mund të japin pëlqimin për një gjë që s'e dinë (se u bë tre herë që e përsëris). Hajde ta ndajmë me votë. Si e kuptoni secili nga ju nenin 45. U bë e qartë që e kuptojmë ndryshe. Ishte ajo që tha Marçela në fillim. Hajde ta ndajmë këtë dhe pastaj të vendosim çfarë do bëjmë, do e përfshijmë apo jo në vendim, nëse do miratohet ai vendimi.

Naureda Llagami: Atëherë, në kushtet që komisioni ka propozuar një projekt-akt, ne do diskutojmë mbi atë që ka propozuar komisioni. Dhe këtu tani diskutimi është si do kalojmë për votim. E para, do kalojmë në votim. Doni të kalojmë nen për nen për votim? Pikën 1 – e miratoni! Pikën 2 – e miratoni!

Ilir Toska: I vetmi propozim konkret është që në pikën 2 të shtohet 'pa lëvizur nga pozicioni ku janë të emëruar' dhe të vazhdojë fjalia.

Naureda Llagami: Jeni dakord?

Ilir Toska: Ky është propozimi.

Naureda Llagami: Ky është propozimi.

E hedhim në votim këtë propozim?

Atëherë, hidhet në votim propozimi për ndryshimin në pikën 2 të projekt-vendimit ku kërkohet që, pas Republikës së Shqipërisë të shtohet togfjalëshi 'pa u lëvizur apo larguar nga pozicioni...'

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Ndajeni njëherë, do ikin apo s'do ikin nga detyra, pastaj t'ia shtojmë.

Naureda Llagami: Atë pra po them.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Marçela Shehu: Kryetare! Ta lejmë ta diskutojmë në momentin që do krijojmë skemën dhe do parashikojmë rregulloren?

(Anëtarët diskutojnë pa ndezur mikrofonat.)

Fatmira Luli: Të them unë diçka?

Një sekondë!

Një sekondë, Bruna!

(Zonja Kryetare dhe zonja Kadi flasin pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Do hedhim në votë propozimin.

Brunilda Kadi: Me variantin që largohen?

Naureda Llagami: Me variantin që largohen.

Brunilda Kadi: Dhe pastaj me variantin që s'largohen.

Naureda Llagami: Dhe me variantin që s'largohen.

Fatmira Luli: Një sekondë!

Ne duhet të...

Naureda Llagami: Po të dyja do hidhen, por do fillojmë me propozimin e ndryshimit dhe pastaj kemi propozimin siç është.

Fatmira Luli: Atëherë hedhim propozimin e parë.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Naureda Llagami: Edhe një herë pra. Hidhet në votim propozimi i bërë nga zonja Lubonja lidhur me ndryshimin në pikën 2 të projekt-vendimit ku kërkohet që, pas shprehjes ‘...Republika e Shqipërisë’, të shtohet ‘...pa u lëvizur nga pozicioni ku janë emëruar/ku ushtrojnë funksionin’, t’i shohim të dyja këto si... Atëherë, e hedhim në votim këtë?

Maksim Qoku: Kundër.

Brunilda Kadi: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Pro.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Kundër.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, miratohet propozimi, miratohet projekt-akti me ndryshimet e propozuara nga zonja Lubonja.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat për disa minuta.)

Fjalën e kërkon zonja Kadi!

Brunilda Kadi: Atëherë, në qoftë se me miratimin e pikës 2, me ndryshimet që u propozuan nga zonja Brikena, që ishin dy variantet, pra që gjyqtarët largohen ose nuk largohen nga vendi i punës, unë vlerësoj se nuk u miratua i gjithë akti, por u miratua vetëm pika 2 e aktit dhe vlerësoj që duhet të hidhet në votim në tërësi akti, sepse të paktën, më duket, nga një pjesë e anëtarëve u kuptua që po diskutohesh pika 2 në votim, jo i gjithë akti. Sepse neve mund të kemi diskutim edhe për pikën 3, 4, 5 e me radhë. Nëse nuk ka diskutim, nga Kryetarja të hidhet në votim në tërësi akti.

Naureda Llagami: Po, zoti Muharremaj!

Erjon Muharremaj: Meqë kolegja Kadi përdori termin -‘nga anëtarët u kuptua akti’, personalisht sqaroj votën time, që kam votuar aktin në tërësi me pikën 2 të ndryshuar. Faleminderit!

Naureda Llagami: Qartë. Tjetër fjalën?

Maksim Qoku: Atëherë, më duhet të sqaroj faktin që u shpreha kundër vetëm për pikën 2 se i mbetem logjikës së leximit të nenit 45 në lidhje me shkëputjen nga pozicioni, por jam pro në tërësi të vendimit të paraqitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pra jam pro për vendimin, kundër vetëm tek pika 2 për pjesën e ndryshimit që u bë. Faleminderit!

Medi Bici: Edhe vota ime ka qenë kundër vetëm për shtesën ‘pa u lëvizur nga detyra ku janë emëruar’. Kurse pjesa tjetër për projekt-vendimin, jam dakord për të gjitha pikat.

Marçela Shehu: Unë kam votuar kundër vetëm për ndryshimin e pikës 2, pra sigurisht që për pjesën tjetër jam dakord sepse jam edhe anëtare e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, pra vendimi ka qenë unanimit, por jam kundër ndryshimeve të pikës 2, që magjistrati nuk quhet i shkëputur nga gjykata ku është emëruar.

Brunilda Kadi: Pra u kuptua që votimi ishte për pikën 2 dhe jo për aktin, -për të sqaruar kolegun Muharremaj, që ai e ka kuptuar që ishte hedhur akti në tërësi. Por sapo u verifikua që tre anëtarë, bashkë edhe unë katër, kanë votuar për pikën 2, jo për aktin në tërësi. Kështu që unë ju ftoj që të hedhim në votim aktin në tërësi dhe të votohet edhe një herë sepse nga ana procedurale, këtë akt administrativ, e keni me probleme procedurale. Unë këtë mendim kam.

Ilir Toska: Kam përshtypjen që ne të shtatë që votuam, ishim të qartë për çfarë votuam. Zonja Kadi konsideroi që disa nga anëtarët nuk kishin kuptuar se për çfarë votuan dhe u shprehën dhe kuptuam edhe votimin në tërësi të aktit. Nuk mendoj se duhet të rivotojmë për së dyti se ne të shtatë të themi po të njëjtën gjë dhe ju të thoni pjesërisht kundër për pikën 2, apo dikush tjetër të thotë, -jam kundër në tërësi.

Brunilda Kadi: Okej! Atëherë, unë që kisha mendim tjetër për pikën 2 dhe kam diçka tjetër për aktin në tërësi, si mund ta shpreh vullnetin në qoftë se nuk shtrohet për votim kjo? Mund të ma shpjegojë dikush nga ju këtë?

Ilir Toska: Kam përshtypjen që u hodh në votim...

Brunilda Kadi: ... Parimi, që votohet një herë nën për nën dhe pastaj për aktin në tërësi. Po kjo është a-ja e miratimit të aktit.

Fatmira Luli: Okej! Çfarë propozimi konkret ke për këtë dispozitë, në qoftë se ke?

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Të hidhet në votim akti në tërësi që të votojmë të gjitha.

Fatmira Luli: Po aktin e kemi miratuar. Se për aktin u shprehën të tërë.

Brunilda Kadi: Atëherë, në qoftë se nuk do hidhet në votim në tërësi akti... Nuk do hidhet në votim në tërësi akti? Se nuk e kuptova?! Të shpreh mendimin tim për aktin në tërësi, siç shprehën tre anëtarët e tjerë.

Naureda Llagami: Hedhim në votim aktin me gjithë ndryshimin e miratuar në pikën 2.

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Brunilda Kadi: Nuk ka pse të flasim pa mikrofonat.

Në qoftë se nuk e hedh aktin në tërësi në votim, unë do shpreh mendimin tim për aktin në tërësi, se nuk mu dha mundësia.

Naureda Llagami: Atëherë, shpreheni mendimin dhe dua propozime konkrete, se keni 20 minuta që shpreheni vetëm në aktin në tërësi.

Brunilda Kadi: Unë mund të marrë edhe 200 milion minuta sepse askush nuk ma ndalon. Ma jep Kushtetuta këtë të drejtë. As ju, askush tjetër nuk më ndërprisni dot fjalën.

Naureda Llagami: Ju lutem, shprehni propozimet! Ju ftoj që të shprehni propozime konkrete.

Brunilda Kadi: E dyta, meqenëse ju refuzoni, në kundërshtim me ligjin, sipas mendimit tim, të hidhni në votim aktin në tërësi, unë, meqenëse nuk mu dha mundësia të shprehem për votim sepse unë kisha një mendim në fillim, por dëgjova edhe kolegët që diskutuam dhe rrugës mund të kem ndryshuar mendimin, prandaj e ke detyrim të më japësh mundësinë të shprehem për aktin në tërësi. Meqenëse nuk ma dhatë në mënyrë formale, unë po shprehem në këtë moment, që unë jam kundër për aktin në tërësi, për

arsyet që i thashë në fillim. Edhe pse dëgjova kolegët, përsëri i qëndroj të njëjtit argument që thashë në fillim. Faleminderit! Kjo ishte e drejta ime kushtetuese që të thosha këtë.

(Anëtarët flasin për disa minuta pa ndezur mikrofonat.)

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 22.01.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Mbi krijimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:15 dhe mbaroi në orën 14:39.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli** (anëtare)
- 4. Medi Bici** (anëtar)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)
- 11. Marçela Shehu** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 6. Përfaqësuese të USAID-it.*

RENDI I DITËS:

2. Mbi krijimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve.

Naureda Llagami: Kalojmë tek pika e dytë e axhendës.

Atëherë, pika e dytë e axhendës është “Mbi krijimin e Komisionit të Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve”.

Arsyeja pse është vendosur kjo çështje në axhendë është që, siç jeni në dijeni, me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ne kemi detyrimin për kryerjen e vlerësimit profesional të subjekteve të rivlerësimit dhe dhënien e ndihmës ndaj organeve të rivlerësimit kalimtar. Kjo detyrë, deri tani, përpara hyrjes në fuqi të... përpara konstituimit të Këshillit, është kryer nga Inspektorati i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kështu, bazuar në nenin 171, pika 2 të ligjit “Për statusin...”, i cili parashikon që: “2. *Menjëherë me ngritjen e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelimit, Këshillat duhet të mbështesin këto organe për realizimin e vlerësimit të aftësive profesionale në përputhje me ligjin e “Rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke ndjekur udhëzimet dhe kërkesat e këtyre organeve. Dhënia e ndihmës për këto organe ka përparësi.* 3. Në të njëjtën kohë me

vlerësimin etik dhe profesional të periudhave 2007-2009, 2010-2012, Këshillat duhet të vlerësojnë magistratët për periudhën e përcaktuar në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. 4. ... Këshilli paraqet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të gjitha dokumentet së bashku me një raport analizues të dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti rivlerësimit, si dhe 5 dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore në respektim të kërkesave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Këshilli, me kërkesë të Komisionit të Pavarur, paraqet dokumentacion të mëtejshëm. Këshilli duhet të ndjekë listën, sipas radhës së kërkuar nga Komisioni i Pavarur.”

Në këtë kuadër kemi menduar që të propozojmë krijimin e një komisioni të përkohshëm me anëtarë të KLGJ-së, i cili duhet të koordinojë të gjithë punët me organin e vlerësimit, deri në paraqitjen në Këshill të raporteve profesionale për miratim. Përbërja e komisionit, unë propozoj që komisioni të jetë, për shkak të ngarkesës që kemi evidentuar deri tani lidhur me procesin e vetingut që mbart KLGJ-ja, propozoj që komisioni duhet të jetë me një përbërje prej 5 vetave, 3 prej të cilëve të jenë pjesë e gjyqësorit dhe 2 të jenë anëtarë jo gjyqtarë.

Kemi diskutime?

Zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Atëherë, në momentin që jam në dijeni, të paktën kështu më është komunikuar, për të qenë një pikë kontakti për sa i përket Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kam filluar ato procedurat për sa i përket realizimit të këtyre shorteve dhe konkretisht bëhet fjalë që më datë 24, pra ditën e enjte, do të realizohet shorti në Gjykatën e Apelit Tiranë, në Gjykatën e Apelit Vlorë si dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, për disa emra (për mos ngrënë kohë, s’po i përmend emrat një nga një).

Pasi bëmë edhe një takim me inspektorët, inspektorët paraprakisht ishin të caktuar më përpara. Kishim disa problematika për sa i përket disa inspektorëve, një inspektor që kishte mbushur moshën e pensionit dhe ishte larguar, si dhe problematika për sa i përket inspektorëve që duhet të ndodheshin në dy vende të ndryshme, në një orar të caktuar. Pra i bie që të ishte njëri në Vlorë dhe në Tiranë në orën 9:00 po ditën e enjte me datë 24. Për këtë u kryen disa veprime, si zëvendësimi i këtyre inspektorëve vetëm për efekt të

hedhjes së shortit. Por problematikat që has ose ka disa problematika të cilat ne më vonë pastaj, me krijimin e këtij grupi të punës unë mendoj që të krijohet një rregullore dhe kjo rregullore do të përcaktojë ndoshta edhe hapat që do të ndiqen që nga ky moment e mbrapa. Por duke qenë se nuk kemi kohë, propozoj që të vijojmë me mënyrën ashtu siç e parashikon ligji, por me një mënyrë tjetër dhe pa rregullore (për datën 24, pra për këtë short) dhe pastaj me një procedurë pak më të shpejtë, grupi i punës që do të caktohet, të përpilojë pra një rregullore ku të përcaktohen detaje dhe të gjitha hapat që do të ndiqen, duke përfshirë këtu edhe shqetësimin e disa prej inspektorëve të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë të cilët thonë që me çfarë statusi do jemi ne aty dhe si do të titullohemi (nëse do të quhemi inspektorë apo...), e cila duhet parë. Pra, gjithmonë kjo bën fjalë për rregulloren që do të miratohet më vonë. Por dua ta them këtë për rekord, pra që të jetë e shënuar, për efekt të ezaurimit për shkak të kohës, të procedurës së hedhjes së shortit me datë 24, pasi në një situatë të tillë kam përshtypjen që rregullorja duhet të miratohej dhe do të sillte shtyrjen e këtij shorti.

Unë këtë kisha merak për ta thënë, pastaj do të jetë vetë grupi i punës që do të detajojë të gjitha procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të kësaj procedure në vijim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit, zoti Hallunaj!

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Unë jam dakord që të ngrihet ky komisioni i përkohshëm dhe komisioni të ketë në përbërjen e tij 5 anëtarë dhe duke ruajtur raportin mes anëtarëve magjistratë dhe anëtarëve jo magjistratë. Ta hedhim në votim këtë pjesë, pastaj për emrat... se shoh që janë shënuar 3 emra këtu. I bie që dikush të propozojë të gjithë emrat apo Kryetarja do propozojë emrat, apo nuk e di se si do të procedojmë.

Naureda Llagami: Unë në fakt do të preferoja që bashkë me miratimin e komisionit, të miratonim edhe me emra, për shkak të ngutshmërisë që ka situata e vlerësimit në këto momente. Sikurse e referoi edhe kolegu, neve pavarësisht miratimit të strukturës tonë dhe të gjitha, ne duhet të operojmë për shkak vetingu, i cili është një proces parësor dhe është një detyrim që na vjen edhe nga dispozita që ju lexova, përparësia që ka vetingu në çdo proces tjetër. Për këtë qëllim, në qoftë se jemi dakord për

përbërjen e komisionit, unë do propozoja edhe emrat konkret, flas për pjesën time, kush do jetë, për emrat konkret lidhur me komisionin.

Atëherë, biem dakord njëherë për ngritjen e komisionit?

Ta kalojmë në votim ngritjen e komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

(Votimi i zotit Toro nuk është regjistruar për shkak se nuk ka patur hapur mikrofonin.)

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, për të kaluar tek propozimi i emrave, unë do të propozoja zotin Dritan Hallunaj si kryetar të komisionit. Do propozoja nga pjesa e anëtarëve jo gjyqtarë zotin Maksim Qoku si edhe zotin Erjon Muharremaj. Ndonjë propozim tjetër për pjesën gjyqësore?

Brunilda Kadi: Paraprakisht, se të kalojmë tek propozimet mendoj që ne Komisioni i Vlerësimit Profesional, nuk mund të përfshihemi në këtë komision. Se mund të ketë problem, në momentin kur të mbarojë vetingu, për gjyqtarët që e kalojnë, kjo dosja do jetë pjesë e vlerësimit, sipas ligjit, kështu që është një lloj... them unë që mos të jemi neve. Megjithëse, okej...

Atëherë, propozojmë zotin Medi Bici, meqenëse është edhe përfaqësues i një shkalle tjetër. Të jenë të tre...

(Zonja Kryetare flet pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Bruna, e moderoj unë. E kishim për propozimin.

Brunilda Kadi: A do bënim propozime?

Naureda Llagami: Bëj propozimin tënd.

Brunilda Kadi: Për Mediun pra thashë. Këtë thashë unë.

(Anëtarët janë dakord për zotin Medi Bici.)

Naureda Llagami: Kisha edhe një merak tjetër lidhur me termin që mund të përdorim.

Po! Përbërja është: Kryetar, Dritan Hallunaj; Anëtar, zoti Medi Bici.

Anëtar tjetër nga gjyqësori?

(Propozohet zoti Ilir Toska.)

Ilir Toska.

Anëtar nga jo gjyqësori – Maksim Qoku dhe anëtar nga jo gjyqësori – Erjon Muharremaj.

Kjo është përbërja e komisionit.

(Hidhet në votim përbërja e komisionit.)

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Pro.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

U miratua dhe ngritja e Komisionit për Vlerësimin Etik dhe Profesional në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, me përbërjen zotin Dritan Hallunaj (anëtar), zoti Maksim Qoku – (anëtar), zoti Ilir Toska (anëtar), zoti Medi Bici (anëtar) dhe zoti Erjon Muharremaj (anëtar). Pika e dytë e vendimit është: 2. Komisioni të ndërveprojë punën e tij me institucionet e rivlerësimit si dhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor për përmbushjen e detyrave të tij përgjatë këtij procesi; 3. Komisioni duhet të ndjekë punën për planifikimin

e shorteve sipas kalendarit të KPK-së, mbledhjen e statistikave, caktimin e inspektorëve përgjegjës, marrjen e masave për zhvillimin e shortit, gjurmimi dhe mbledhjen e dosjeve të zgjedhura me short, hartimin e raportit, inventarizimin dhe dorëzimin e raportit pranë KPK-së; 4. Merren masat dhe orienton administratën të bëjë njoftimet në lidhje me kryetarët e gjykatave apo gjyqtarët që do të shorthen.

Erjon Muharremaj: Nëse mundem të bëj një ndërhyrje në lidhje me pikën 2, ku thuhet '...komisioni të ndërveprojë punën e tij'. Mendoj që duhet '...komisioni të ndërveprojë gjatë punës së tij' ose '...koordinon punën e tij me institucionet'.

Naureda Llagami: '...gjatë punës së tij' ose '...koordinon'.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit! Po!

Ilir Toska: Kam përshtypjen që zoti Hallunaj, në fjalën e tij, konsideroi që duhet të kishte ca rregulla ky komisioni. Mund të vendosim një pikë shtesë që, Komisioni të hartojë një draft për rregullat që duhet të ndjekë për të realizuar detyrën e tij.

Naureda Llagami: Atëherë, propozimi është që në pikën 5, komisioni të miratojë rregulla për funksionimin e tij. Të shtohet.

Maksim Qoku: Dakord.

(Fjala e zonjës Kadi nuk është regjistruar, ka qenë mikrofondi i fikur.)

Dritan Hallunaj: Dakord.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Kemi çështje të tjera për të diskutuar?

Medi Bici: Kisha unë një çështje.

Naureda Llagami: Po! Po, zoti Medi!

Medi Bici: Tani, në mbledhjen e fundit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Kryetari i Këshillit të Emërimeve pretendoi që i ka drejtuar edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë një kërkesë për të ulur ngarkesën e gjyqtarëve dhe prokurorëve që janë pjesë e këtij Këshilli. Nëse ka ardhur kjo kërkesë, do kërkoja që ta fusni në rendin e ditës në mbledhjet e ardhshme.

Naureda Llagami: Me dijeninë time, deri sot, kjo kërkesë nuk ka ardhur, nuk është administruar, protokolluar akoma pranë institucionit tonë. Me ardhjen e kësaj kërkesë, do e trajtojmë sipas procedurave.

Brunilda Kadi: Edhe unë kam dy diskutime që të kihen parasysh edhe për mbledhjet e tjera por edhe jashtë mbledhjes.

E para, neve komunikojmë, na marrin gjyqtarët dhe na pyesin dhe na japin informacione që, kemi sjellë këtë kërkesë, kemi bërë këtë gjë, kemi propozuar këtë. Unë mendoj që çdo gjë që vjen në protokoll dhe i drejtohet Këshillit, duhet domosdoshmërisht të njihen të gjithë anëtarët, çfarëdo lloj informacioni, në qoftë se ai nuk drejtohet specifikisht tek Kryetari, e para.

E dyta, ka një të dhënë se çfarë po ndodh me ankesat? Çfarë po bëhet me ankesat? Se unë e kam ngritur si shqetësim edhe në mbledhjet e mëparshme. Çfarë po ndodh me ankimet që vjen bën populli për forcë të zakonit sepse ato nuk e dinë ligjin që ka ndryshuar dhe më the e të thashë, të gjithë shqetësimet që i kemi pasur dhe i kemi ngritur. Çfarë po bëhet? Ku arkivohen? Ku mblidhen këto ankesa? Dhe kush po i kthen përgjigje? Çfarë po bëhet me këto? Se mendoj që është një problem që duhet ta zgjidhë Këshilli. Nuk besoj se zgjidhet në rrugë administrative, që mund t'i japë përgjigje për shembull Sekretari i Përgjithshëm apo edhe Kryetari në pozicionin e tij administrativ. Është një çështje që duhet të marrë vendim Këshilli dhe ne duhet të kemi informacion të gjithë sepse nuk është e drejtë që ne të na pyesin gjyqtarët ose edhe subjekte të tjera dhe të mos dimë se çfarë bëhet.

Naureda Llagami: Atëherë, zonja Bruna, për informacion, i gjithë protokollit që administrohet pranë zyrës së protokollit në Këshillin Gjyqësor i shpërndahet stafit administrativ në kushtet që ne akoma nuk kishim një ndarje të komisioneve. Në situatën që ne sot kemi një ndarje në komisione dhe kemi një shpërndarje të të gjithë anëtarëve në

bazë të komisioneve dhe kryetarët e zgjedhur tashmë, komplet stafi administrativ, pasi përpunon shkresat, do ia kalojë komisioneve përkatëse, sipas kompetencave, fushës së kompetencës së tyre.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Stafi administrativ e di se kujt i përket një kërkesë, cilit komision. Nuk ka të bëjë... Se ky është një diskutim goxha...

(Zonja Kadi ndez mikrofonin.)

Pra stafi administrativ përcakton që një çështje e caktuar i takon një iks komisioni ose ipsilon komisioni? Unë mendoj që duhet t'i vijë për informim të gjithë anëtarëve. Them unë.

Naureda Llagami: Atëherë, këto janë çështje, zonja Bruna, që ne do t'i zgjidhim tek rregullorja jonë e brendshme dhe janë jashtë diskutimit të, qëllimit të mbledhjes së sotshme.

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Unë ngre shqetësimin.

Naureda Llagami: Po! Ngre shqetësimin. Nëse ju keni një shqetësim konkret që ka ardhur diçka dhe nuk është trajtuar dhe nuk është informuar, pa diskutim që do ta adresojmë.

Brunilda Kadi: Unë problem shqetësimin sepse duhet të kem informacionin njëherë.

Naureda Llagami: O Bruna, ta mbaroj unë fjalën të lutem?

Lidhur me pjesën e ankesave që është një çështje me shumë përparësi dhe që na shqetëson shumë që të gjithëve bashkë pjesa e ankesave, ashtu sikurse jua kam informuar edhe tek mbledhja e mëparshme, kemi krijuar një regjistër pranë ankesave. Në momentin që këto ankesa... është krijuar edhe Komisioni i Disiplinës, këto ankesa, do i kalojnë një kopje, komplet siç janë, me gjithë regjistrin, Komisionit të Disiplinës. Me idenë që ato të mbahen aty deri në krijimin e institucioneve përkatëse, që do i kalohen më pas në mënyrë zyrtare institucioneve përkatëse.

Brunilda Kadi: Kush e vendosi këtë që i kalojnë Komisionit të Disiplinës dhe paska ai të drejtë të bëjë këtë regjistrin dhe t'i mbajë këto ankimet? Kush e vendosi këtë gjë?

Marçela Shehu: A mund të bëj një propozim?

Naureda Llagami: Po!

Marçela Shehu: Në analizë të atyre që u diskutuan, unë jam dakord që ne duhet të jemi në dijeni të shkresave që vijnë në drejtim të Këshillit, por gjithashtu jam edhe dakord me faktin që këto shkresa duhet t'i adresohen një komisioni të caktuar, ndoshta kjo ka qenë edhe arsyeja pse nuk janë shpërndarë deri tani. Mendoj që ne jemi në kushtet e nevojës së madhe që të bëjmë një rregullore si do funksionojë Këshilli dhe si do funksionojë secili komision.

Pra është e drejtë ajo, se nuk mund t'ia lejmë edhe administratës të na e përcaktoi që kjo shkresa i përket këtij komisioni apo jo. Jo se ata nuk kanë njohuritë e duhura për ta bërë, por mund të jenë gjëra aq delikate sa që edhe për ne mund të ketë vend për diskutim. Kështu që, të fillojmë nga a-ja, të mendojmë të bëjmë një rregullore si do funksionojë Këshilli; ku fillon e ku mbaron kompetenca e çdo Këshilli, që mos të kemi diskutime të tilla.

Naureda Llagami: Në qoftë se e mban mend si e nisa fjalinë, ju thashë çfarë është bërë deri tani. Në këto momente që ju jeni ndarë nëpër komisione, e gjithë praktika do ju shpërndahet ju sipas komisioneve përkatëse. Deri tani, i ka mbajtur, ka vijuar procesi siç ka qenë më përpara, lidhur me administrimin e dosjeve, duke ndarë edhe disa grupe pune për çështje imediate siç ishte çështja e delegimit, duke diskutuar edhe për miratimin e rregulloreve, kemi filluar punën nga ana e administratës. Sot që ne flasim me komisione dhe sot që ne kemi veprimet e para të komisioneve, pa diskutim që shkresat, si do vijnë, do i kalojnë për kompetencë komisionit përkatës dhe komisioni përkatës le t'i trajtojë, le t'i propozojë për rend dite, është proces tjetër. Sikurse edhe pjesë e Komisionit të Disiplinës janë edhe ankesat. Komisioni nuk mund të veprojë dot ankesa, por për efekt të evidentimit të këtyre, unë nuk e di kujt komisioni mund t'ia çojmë këto ankesa. Unë për veten time, duke parë edhe ligjin dhe kompetencat, ankesat ndaj gjyqtarëve unë nuk e mendoj dot se kujt komisioni tjetër mund t'ia kalojmë për administrim. Thjesht ju kujtoj

për pjesë administrimi dhe evidentimi të protokollit të këtyre ankesave sepse për trajtim, jam e bindur që asnjëri nga ne nuk mund të pranojmë dot trajtim ankesash, nëse nuk na sillet dhe të bëhet hetimi nga organi që parashikon ligji.

Brunilda Kadi: Atëherë unë mendoj që nuk është kompetencë e Kryetarit të lexojë ai në fillim dhe në fund ligjin dhe të përcaktojë se kujt i takon çfarë. Pikërisht se ka qenë e diskutueshme, duhet të diskutoheshe në Këshill, se nuk e ka këtë kompetencë Kryetari i Këshillit. Kryetari, në funksion me anëtarët ka përgjegjësi. Nuk ka kompetencë të lexoj ligjin në mënyrë fundore dhe ta vlerësojë vet se çfarë duhet të bëjë. Për këtë e kisha diskutimin, e para. E dyta, nëse mua si anëtar nuk më vijnë e evidentuar një moment i caktuar një ankim, një sugjerim, një kërkesë (nuk e di se çfarë mund të them), unë nuk mbaj asnjë lloj përgjegjësie. Le ta mbajnë përgjegjësinë ata që i mbajnë këto akte dhe nuk e di se ku i çojnë.

Naureda Llagami: Ndonjë çështje tjetër për diskutim?

Jo!

Faleminderit për prezencën.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor